



**Broshurë informuese  
mbi NYSESLAT-in për prindërit**

Mirë se vini! Misioni i Departamentit të Arsimimit të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Education Department's - NYSED), Zyra e Arsimit Bilingual dhe Gjuhëve të Botës (Office of Bilingual Education and World Languages - OBEWL) është të sigurojë se të gjithë studentët e shtetit të Nju Jorkut (New York State - NYS), përfshi këtu edhe Nxënësit e Gjuhës Angleze (English Language Learners - ELL)/Nxënësit Shumë-Gjuhësor (Multilingual Learners - MLL), të kenë sukses në nivelet më të larta akademike dhe kompetencat gjuhësore. Ne përpiqemi shumë për t'u siguruar se rrugëtimi arsimor individual i çdo nxënësi dhe nevojat e tij socio-emocionale të përmbushen në shumë gjuhë, duke i përgatitur ata për universitet e duke i aftësuar në karrierë. Çdo vit, fëmijës tuaj u bëhet një vlerësim të aftësive gjuhësore, Testi i Arritjeve në Anglisht si Gjuhë të Dytë nga Shteti i Nju Jorkut (New York State English as a Second Language Achievement Test - NYSESLAT).

#### **HYRJA**

NYSESLAT-i u behet të gjithë nxënësve që janë identifikuar si ELL/MLL në Testin e Identifikimit të Shtetit të Nju Jorkut për Nxënësit e Gjuhës Angleze (the New York State Identification Test for English Language Learners - NYSITELL). Qëllimi i NYSESLAT-it është të vlerësojë çdo vit nivelin e zotërimit të gjuhës angleze te ELL/MLL-ve të regjistruar nga kopshti e deri në klasën e 12-të në shkollat e Shtetit të Nju Jorkut. Testi i jep shtetit, shkollave, prindërve dhe mësuesve të dhëna të rëndësishme mbi zhvillimin e gjuhës angleze te ELL/MLL-të.

#### **KUR MBAHET NYSESLAT-i?**

NYSESLAT-i zakonisht mbahet në pranverë, gjatë muajve prill dhe maj.

#### **ÇFARË LLOJ PYETJESH DO T'U BËHEN NXËNËSVE?**

NYSESLAT-i përfshin pyetje me alternativa, pyetje me përgjigje të shkurtra, pyetje me përgjigje të gjata dhe pyetje me gojë në kategoritë e dëgjimit, të folurit dhe të shkruarit në anglisht. Fëmija juaj duhet t'i nënshtrohet të gjitha pjesëve të testit. Pyetjet e NYSESLAT-it reflektojnë llojet e aktiviteteve dhe detyrave që fëmija juaj zhvillon në klasë.

#### **KUSH E ADMINISTRON NYSESLAT-in?**


NYSESLAT-i administrohet nga arsimtarë të kualifikuar të Shtetit të Nju Jorkut.

#### **SI MUND TË PËRFTOJ NJË KOPJE TË REZULTATIT TË FËMIJËS TIM NË NYSESLAT?**

Shkolla do t'ju sigurojë një raport mbi rezultatin e NYSESLAT-it ku do të gjeni të dhëna specifike mbi progresin e zhvillimit të fëmijës suaj në gjuhën angleze.

## CILAT JANË NIVELET E ZOTËRIMIT TË GJUHËS ANGLEZE PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016 DHE MË TEJ?

Zotërimi i gjuhës angleze ka kaluar nga katër në pesë nivele zotërimi në mënyrë që të ketë më shumë ndarje mes nxënësve:



## ÇFARË KUPTIMI KANË NIVELET E ZOTËRIMIT TË ANGLISHTES?

Në tabelën e mëposhtme do të gjeni një përshkrim të Niveleve të Zotërimin të NYSESLAT-it.

Niveli	Përshkrimi i Nivelit të Zotërimin të Gjuhës Angleze	
<b>Hyrja (Fillimi)</b>	Një nxënës në nivelin e Hyrjes është shumë i varur në mbështetjen dhe strukturat për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike dhe ende nuk përmbush kërkesat linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike.	<b>E përshatshme për Shërbimet e ELL-së</b>
<b>Zhvillimi (Mesatar i Ulët)</b>	Një nxënës në nivelin e Zhvillimit është disi i varur në mbështetjen dhe strukturat për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike dhe ende nuk përmbush kërkesat linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike.	
<b>Kalimi (Mesatar)</b>	Një nxënës në nivelin e Kalimit është disi i pavarur për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike, por ende nuk përmbush kërkesat linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike.	
<b>Zgjerimi (I Avancuar)</b>	Një nxënës në nivelin e Zgjerimit është shumë i pavarur për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike dhe i përafrohet kërkesave linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike.	
<b>Zotërimi (Ekspert)</b>	Një nxënës në nivelin e Zotërimin përmbush kërkesat linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike. Një nxënës i këtij niveli nuk konsiderohet më nxënës ELL, por mund të përfitojë për dy vite nga shërbimet e ish ELL-ve.	<b>E papërshatshme për Shërbimet e ELL-së</b>

## NËSE FËMIJA IM KA IEP, A LEJOHET AKOMODIMI I TESTIMIT GJATË NYSESLAT?

Po, akomodimet e testimit sigurohen për ELL-të me Programe Arsimimi të Individualizuara “Individualized Education Programs (IEPs)” gjatë testimit të NYSESLAT. Flisni me mësuesin e fëmijës tuaj për të marrë informacione specifike në lidhje me akomodimet për të cilat mund të ketë të drejtë fëmijë juaj. Për informacione të mëtejshme, ju lutem vizitoni: <http://www.p12.nysed.gov/assessment/nyseslat/>

## ÇFARË SHËRBIMESH GËZON FËMIJA IM SI ELL/MLL?

Fëmija juaj gëzon të drejtën e shërbimeve të Arsimimit Bilingual (Kalimi ose Dy-Gjuhësh) dhe/apo të Anglishtes si një Gjuhë e Re “English as a New Language (ENL)”. Niveli i zotërimit i fëmijës tuaj përcakton minutat e orë e shërbimeve ELL (orëve të mësimi) që ai ose ajo do të kenë gjatë javës. Shihni grafikun poshtë për detaje specifike mbi nivelin e gjuhës.

Niveli	Klasat K-8 Detajet e Udhëzimeve javore të ENL-së	Klasat 9-12 Detajet e Udhëzimeve javore të ENL-së *	Studentët në Programet Bilinguale
Hyrja (Fillimi)	360 minuta	540 minuta	<ul style="list-style-type: none"><li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li><li>• Minimumi dy lëndë me përmbajtje bilinguale</li></ul>
Zhvillimi (Mesatar i ulët)	360 minuta	360 minuta	<ul style="list-style-type: none"><li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li><li>• Minimumi dy lëndë me përmbajtje bilinguale</li></ul>
Kalimi (Mesatar)	180 minuta	180 minuta	<ul style="list-style-type: none"><li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li><li>• Minimumi një lëndë me përmbajtje bilinguale</li></ul>
Zgjerimi (I avancuar)	180 minuta	180 minuta	<ul style="list-style-type: none"><li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li><li>• Minimumi një lëndë me përmbajtje bilinguale</li></ul>
Zotërimi (Ekspert)	Një nxënës në nivelin e Zotërimit ka përmbushur të gjitha kërkesat linguistike të nevojshme për të demonstruar zotërimin e gjuhës angleze në një sërë kontekstesh (mjedisesh) akademike. Një nxënës në këtë nivel nuk konsiderohet më një nxënës ELL, por fiton të drejtën për të fituar dy vjet shërbime si ish-ELL.		

\*Një pjesë e udhëzimeve të ENL-së mund të jepen përmes një ore mësimi me përmbajtje të integruar.

## ÇFARË JANË SHËRBIMET SI ish-ELL?

Sapo një nxënës arrin nivelin e Zotërimit (Ekspert), studenti nuk konsiderohet më si ELL dhe nuk gëzon më të drejtën e shërbimeve si ELL, por gëzon të drejtat për shërbime si ish-ELL. Ish-shërbimet e ELL-së përfshijnë .5 njësi studimi në javë të ENL-së së integruar në ELA/Lëndën e Përmbajtjes Thelbësore, ose shërbime të tjera të aprovuara për ish-ELL edhe për dy vite të tjera. Këta nxënës duhet të vazhdojnë të marrin mbështetje të individualizuar në mësim-nxënie dhe të testohen për përparimin gjuhësor dhe akademik për të përmirësuar rezultatet akademike.

## **SI MUND TA NDIHMOJ FËMIJËN TIM TË PËRGATITET PËR NYSESLAT-IN?**

Prindërit mund të bëjnë disa gjëra për të ndihmuar nxënësit të përgatiten për NYSESLAT-in. Ja disa sugjerime:

- Sigurohuni që fëmija juaj të flejë mjaftueshëm dhe të hajë vakte të ekuilibruara nga ana ushqimore përpara çdo seance testimi.
- Inkurajoheni dhe jepini siguri në lidhje me testimin, sepse kjo gjë mund të ndikojë pozitivisht në rezultatet e testimit të fëmijës tuaj.
- Lexoni dhe shqyrtoni bashkë me fëmijën tuaj çdo informacion që merrni në lidhje me përvojën e testimit.
- Sigurojeni fëmijën tuaj që ky testim kryhet për të matur zhvillimin e tij ose të saj gjuhësor.
- Takohuni dhe punoni nga afër me klasën e fëmijës dhe mësuesin e Anglishtes si një Gjuhë e Re/Anglishtes si Gjuhë e Dytë (ENL/ESL) apo atë Bilingual për mbështetje dhe rekomandime specifike të cilat mund t'ia jepni ju në shtëpi.

## **BURIME DHE NDIHMË SHITESË**

Informacion në lidhje me NYSESLAT-in mund të gjendet në <http://www.p12.nysed.gov/assessment/nyseslat/> dhe <https://www.engageny.org/resource/spring-2015-nyseslat-resources>. Nëse keni pyetje të mëtejshme në lidhje me nivelin e zotërimit të gjuhës angleze të fëmijës tuaj, ju lutem kontaktoni me [emscassessinfo@nysed.gov](mailto:emscassessinfo@nysed.gov) ose telefononi 518-474-5902. Pyetjet në lidhje me shërbimet bilinguale/ENL mund t'i drejtohen Zyrës së Arsimimit Bilingual dhe Gjuhëve të Botës (OBEWL) përmes telefonit në numrin 518-474-8775, ose përmes e-mail te [obefls@nysed.gov](mailto:obefls@nysed.gov).

Për pyetje dhe shqetësime në lidhje me shërbimet ELL, ju lutem kontaktoni

[nysparenthotline@nyu.edu](mailto:nysparenthotline@nyu.edu)

Linja e ndihmës për prindin ELL: (800) 469-8224

**Pyetje të tjera?**

Ju lutem na dërgoni pyetje a komente në Zyrën e Arsimit

Bilingual dhe Gjuhëve të Botës [OBFLS@nysed.gov](mailto:OBFLS@nysed.gov)

Ose na telefononi në: 718-722-2445

Për më shumë të dhëna mbi NYSESLAT vizitoni:

<http://www.p12.nysed.gov/assessment/nyseslat/>

